

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 364 / Prot.
3

Tiranë, më 14 . 02 . 2025

VENDIM
Nr. 7 , datë 14 . 02 . 2025

PËR
“MIRATIMIN E MASËS SË TRAJTIMIT FINANCIAR PËR SEKRETARIN TEKNIK TË
KËSHILLIT TË BOTIMEVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në Kodin e Punës në RSH, neni 90, pika 1; në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; neni 49, pika 1; në Statutin e UMT-së, neni 24, pika 7 dhe neni 51, pika 1, shkronja “u”; në Relacionin nr. 3772, datë 18.12.2023 të Kryetarit të Senatit Akademik të UMT-së, në mbledhjen e datës 20.12.2023, në Vendimin e BA nr. 3, datë 10.01.2020 “Për pagesën e orëve të sekretarive të organeve kolegjiale të UMT-së”, si dhe në Vendimin nr. 8, datë 31.01.2025 të Senatit Akademik të UMT-së, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë trajtimin financiar mbi kohën normale të punës, sipas legjislacionit në fuqi, për sekretarin teknik në Këshillin e Botimeve.
2. Ngarkohet Administratori i UMT-së dhe Këshilli i Etikës në UMT, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË
VERA OSTRENI

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ